

## Aleksandër Moisiu, Muze, shtëpia që nuk u ndërtua kurrë

( 25/11/07)

Një muze për Aleksandër Moisiun. Nuk është thjeshtë një ide. Është një projekt i përfunduar nga një zyrë arkitektësh shqiptarë në Gjermani, sipas një maketi të hershëm, realizuar nga një arkitekt i famshëm vjenez, Adolf Los. Në të vërtetë, Los kishte projektuar një vilë, një shtëpi banimi për Aleksandër Moisiun, të atillë që aktori shqiptar me famë europiane e dëshiroi aq shumë. Por ai mbeti vetëm maket. S' dihet pse nuk u realizua kurrë.

Arkitekti shqiptar, Ernest Ferizi, i cili e ushtron zanatin e tij prej vitesh në Gjermani, thotë se pasi janë njohur me punimin e arkitektit të famshëm austriak, ju ka lindur ideja për ngritjen e muzeut. Ai tregon imtësisht për të përditshmen "Ekspres" në Kosovë, idetë avanguardë të arkitektit, dhe sidomos të këtij projekti, njohjen e Adolf Los me aktorin Moisiu dhe sidomos përshkrimin e ambienteve të shtëpisë së ëndërruar të aktorit.

Vendi ku do të ngrihet muzeu? Projektuesit ende nuk janë të vendosur përfundimisht. Mund të jetë Durrësi, qyteti i lindjes së aktorit legjendë, por mund të jetë edhe Lugano, në Zvicër, ku edhe prehen eshtrat e aktorit të famshëm shqiptar.

### Arkitekti skandaloz

Ernest Ferizi na njeh fillimisht me idetë e arkitektit vjenez, Los që iu kundërvu mentalitetit në mbarë Europën e viteve '20. "Arkitekti vjenez, Adolf Los, është i njohur për shumë objekte e ndërtesa projektuar prej tij anembanë Evropës. Pikërisht ky arkitekt projektoi edhe shtëpinë e artistit tonë të madh, Aleksandër Moisiut, në Lido të Venedikut", - shkruan Ferizi, arkitekt në Gjermani. Adolf Los, si duket ishte i vetmi arkitekt që ngriti zërin dhe iu kundërvu dekorimeve ornamentike të fasadave, që atëbotë (pra në fillim të shekullit XX), e kishin ngulfatur Vjenën e Straussit, Mozartit, Schiles, Zveigut, Leharit, etj. Pra, po atë Vjenë që konsiderohej një prej qendrave më të mëdha kulturore dhe artistike në Evropën e atëhershme. Ferizi argumenton se meqë Losi merrej edhe me estetikë dhe teori të arkitekturës, shkroi edhe kritika mbi fenomenin e dekorimeve ornamentale, përkatësisht mbi çoroditjen e fasadave me këso ornamente triviale. Ai shkroi madje edhe vepra, nga të cilat dallohen dy të tilla, me tituj mjaft provokues: "Ornamentet si Krime" dhe "Të Folurit në të Zbrazët", që shkaktuan reagime të mëdha në opinionin vjenez, sidomos midis atyre që nuk e kuptonin konceptin risimtar arkitekturor të Losit. Por kulminacioni i reagimeve arriti kur ky projektoi dhe realizoi, mu në zemrën e Vjenës, objektin Haus am Michaelerplatz, me forma të pastra dhe me fasada të liruara nga ky lloj dekorimi, pra kur solli një objekt të konceptuar krejtësisht ndryshe nga ato që prej kohësh gjendeshin në Vjenë. Kjo mjaftoi që Losi të cilësohej si arkitekt skandaloz, të bëhej i padëshiruar e madje edhe i urryer nga bashkëkohësit e tij, sado që në heshtje e respektonin dhe e çmonin guximin e tij për t'i thyer rregullat arkitekturore të cilave u kishte kaluar koha.

### Takimi i Moisiut

#### me Adolf Los

Fati deshi që pikërisht rrugët e arkitektit Adolf Los të kryqëzoheshin me ato të një artisti të madh të asaj kohe, Aleksandër Moisiu. Aktori Moisiu asokohe ishte 20-vjeç, kur së bashku me nënën dhe dy motrat shkeli në Vjenë. Pasionet dhe ëndrrat për t'u bërë artist ishin të vetmet begati që kishte Moisiu i ri. Mirëpo edhe ato ia prishnin atëbotë komisionet e ndryshme sprovuese, duke gjetur se "Aleksandër Moisiu mund të bëhej çdo gjë tjetër, por jo artist". Megjithëse siç thoshte ai: "Rrugët e fatit janë të mrekullueshme". Ia doli të bëhej aktor, madje jo vetëm kaq, duke luajtur në 90 role të ndryshme të autorëve më të rëndësishëm të dramaturgjisë klasike dhe të kohës. U ngrit në majat më të larta të artit skenik evropian e më gjerë. Kritiku Artur Kahane, për Aleksandër Moisiun, shkruante se të krijonte përshtypje se ishte i adhuruari i perëndive dhe se vetë perënditë ia kishin vënë vetes kusht për t'ia lehtësuar punën. Aleksandër Moisiu u fliste njerëzve me gjuhën e zemrës, me gjuhën e artit skenik, të cilën ai e dinte më së miri: gjermanëve u fliste me gjuhën e Goethes e Schilerit; anglezëve me gjuhën e Sheakspearit e të Show-t; rusëve me gjuhën e Tolstoit e Dostojevskit; kurse francezëve me gjuhën e Molierit, etj. Dhe, siç thonë biografët dhe bashkëkohanikët e Moisiut, nuk ka asnjë aktor që është adhuruar si ai dhe njëherësh, nuk ka asnjë tjetër që u përdoq aq shumë. Mbase pikërisht për këtë fakt, Moisiu vendosi që realizimin e një vile, që me kohë i ishte bërë pasion dhe i sillej nëpër kokë, t'ia besonte Losit, gjithashtu aq i përndjekur për idetë e tij novatore.

Pas 20 vjetësh...

Tashmë, kur ishte bërë i famshëm dhe kishte shumë para, Moisiu shfrytëzoi mundësinë që derisa gjendej në turne nëpër Itali, Zvicër e Vjenë, ta sendërtonte pasionin e kahmotshëm. Siç shkruan Ferizi, "në vitin 1923, ai angazhoi arkitektin austriak, Los, për t'ia bërë projektin për vilën, përkatësisht për shtëpinë, të cilën mendonte ta ndërtonte në Lido, të Venedikut. Pra, pikërisht aty ku para 20 vjetësh kishte debutuar si këngëtar, në operën 'Lucia Lamurmur'".

Vila e Aleksandër Moisiut, e projektuar nga Losi, është e përmasave 14 x 11.50 metra. Pjesa e parë e saj është e “thyer” për një të katërtën, duke formuar kështu tarracën, e cila shtrihet gati mbi tërë katin e sipërm, që ishte paraparë për solemnitete e takime miqsh. Arkitekti austriak njihej si një prej interioristëve më të shquar të asaj kohe, prandaj edhe bukuria e fasadave të shtëpisë së Moisiut nuk ishte e rastësishme, ngase ajo reflektohej nga brendia e objektit.

Përshkrimi i vilës  
së Moisiut

Losi ishte edhe arkitekt me sensibilitet të shquar. Sensibiliteti i tij vjen në shprehje atëherë kur sajon dritaret e vogla, të projektuara në pjesën më të ngrohtë të fasadës jugore dhe kur projekton dritaret e mëdha 3x2 m, të vendosura në fasadën lindore – në drejtim të detit. Pjesa e objektit që më së paku i ekspozohet diellit, pra ajo veriore, është e ndarë në dy pjesë: në hapësirën e lartë, ku gjenden dhomat e banimit; dhe në hapësirën e poshtme, ku është projektuar një boshllëk dedikuar kuzhinës dhe elementeve të saj. Ndryshe, i tërë objekti është i furnizuar me dritë natyrore, përveç korridorit që lidh dhomat e mysafirëve, e që furnizohet me dritën që vjen nga xhami i tarracës së katit të parë. Vila e artistit tonë është karakteristike edhe në bazë të dy funksioneve: funksionit të banimit familjar dhe atij për mysafirë. Kati i parë i dedikohet ahengjeve dhe mbrëmjeve solemne me miq, të ftuar, ose me establishmentin artistik e kulturor – pra me ‘jet–setin’ e atëhershëm. Aty ndodhen edhe dhoma e ngrënies, ajo e muzikës, biblioteka, por edhe salloni i pajisur me kaminë.

Shtëpia që nuk u  
ngrit kurrë

Sot askush nuk mund ta shpjegojë faktin pse e gjithë kjo ide mbeti vetëm në letër. Kur projekti u përgatit për realizim, madje u bë edhe modeli, përkatësisht maketi, i cili në mënyrë plastike prezantonte pamjen konkrete të vilës së Moisiut, për shkaqe që nuk dihen ajo nuk u realizua fare. Pra, gjithçka sa u shpjegua më lart ngeli si projekt e maket. Ky maket, me të gjitha skicat dhe projektet përcjellëse u ekspozua në Sallonin Vjeshtor të Parisit, në vitin 1923, ku zgjoi interesim të madh. E pikërisht në saje të interesimit që u tregua për të, ky projekt u prezantua edhe në Trienalen e Milanos, një ekspozitë kjo e njohur me karakter ndërkombëtar.

Sendet personale të aktorit...

Në saje të materialit të mbetur, ekipi i arkitektëve shqiptarë, “Ferizi+Ferizi”, bëri një rikonstruktim me të cilin vila apo shtëpia e Aleksandër Moisiut do të mund të shndërrohej në Muze, ku do të vendoseshin të gjitha sendet personale, objektet, të dhënat jetësore e aktorese të këtij artisti të madh. Kështu, vila e artistit nuk do të shërbente si shtëpi banimi, siç dëshironte atëbotë Moisiu, por do të kishte fatin e një Muzeu për të gjithë adhuruesit e mirëfilltë të artit skenik, e sidomos për adhuruesit e Aleksandër Moisiut. Ekzistojnë dy opsione për vendin e ndërtimit të këtij muzeu: i pari opsion është Durrësi, prej nga edhe vjen artisti dhe familja e tij; ndërsa opsioni i dytë është Lugano në Zvicër, ku edhe prehen eshtrat e aktorit të shquar shqiptar. Në këtë mënyrë do të nderohej aktori ynë i madh, ndërkohë që arti dhe kultura shqiptare do të fitonin edhe një objekt të rëndësishëm dhe gjithsesi, monumental.